

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali i SHISH/ Alizoti: Rama është errësira, - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919032/skandali-i-shish-alizoti-rama-eshte-erresira-menaxheri-truri-qe-mbledh-pisllekun-qe-ka-pushtuar-shtetin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 07:41:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 07:27:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e6e58a5e905fb7bdc40c02bc5d32f523e7f5dd84430f83dec387a61bd547209
TEKSTI	98babccb9b5366d92edfd3848819c0754b1b989cd8375cfba981a105d7daef4d
PAMJA	1d5cf22ff2fb4e5844673617db564895d10e5cd1ce4c05cb78a076723f41f7d5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5786f4472e967138ab32e2998c4ac04290c7657228556ef1fdc7ef2077270b75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5786f4472e967138ab32e2998c4ac04290c7657228556ef1fdc7ef2077270b75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës

më të lexuarat

Mashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë

'Garancia e plotë' e Ramës dhe
përgjegjësia e tij politike për Vlora
Hysenin

Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo
është rënia e shtetit, është bashkuar me
krimin

Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të
Ramës

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon
Shqipërinë 2026



Skandali i SHISH/ Alizoti: Rama është errësira, menaxheri, truri që mbledh pissllëkun që ka pushtuar shtetin

09:27, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Në emisionin e mëngjesit 'Kafe Shqeto' në Syri tv ka qenë i ftuar deputeti i Partisë
Demokratike Tomorr Alizoti.

Në bisedë me moderatorin Flavio Qarri ai ka komentuar zhvillimet e fundit në vend
pas skandalit të madh të SHISH.

Flavio Qarri: Çfarë duhet të ndodhë më në këtë vend që të kemi mbajtjen e një përgjegjësisë nga ana e mazhorancës?

Tomorr Alizoti: Nuk ka ç'ndodh më, sepse shërbimet sekrete janë thelbi i shtetit.
Janë gjithçkaje e shetit. Shteti në konceptin e tij ka sigurinë e individit dhe
informacionin e individit dhe prandaj i jepet e drejta që të përdorë, të ushtrojë në
masë të rregullt forcën për të mbrojtur individin dhe për të mbrojtur të drejtat e
grupit të njerëzve që jetojnë në atë vend. Dhe ky shtet, tani, jo vetëm që nuk
mbron të drejtat e individit që ti japë sigurinë dhe garancinë por ky atë që e ka
kundërshtar, nuk e ka më as aleat, ai e kontrollon këtë. Pra nëse dikur, pa bërë
filozofi, ata që do të drejtonin shtetin duhet të ishin më të diturit, më të urtit në
filozofinë e lashtë, sot kanë dalë më horrat me të keqinjtë më banalët, ku drejtojnë
gjithçka në këtë vend.

Unë jam deputet. Nuk e takon dot Drejtorin e Shërbimit Informativ. Është shumë e
vështirë ta takosh, është njeri shumë i rëndësishëm. Imagjinoni sikur drejtorin e
CIA, apo KGB, ta takonte një gangster lagjeje.

Në koncept, në logjikë, bie i tërë shteti. Shërbimet sekrete kanë qene edhe në
shërbim të sistemeve totalitare, të komunizmit, të fashizmit. Por kjo këtu, kjo është
denigrimi, shkatërrimi total. Që njerëzit banalë të rrugës të llumit, që përveç kësaj
kanë marrë fytirën e çdo shqiptari që jeton nëpër botë. Pra nëse ajo policia në
kufi e mban shqiptarin me orë të tëra duke e kontrolluar sepse mendon se ky
shqiptari i thjeshtë mund të shesë drogë, mund të bëjë këtë....pikërisht këta
njerëz, këto lloj grupimesh ja kanë marrë atë imazhin shqiptarit. Tani këtë vijnë
dhe kontrollojnë shërbimin informativ dhe një hamendësia ime është, ore si munda
një njeri banal të gjejë kontaktin drejt tek drejtori i një institucioni kaq të
rëndësishëm që edhe kur kalon kufirin, nuk shënohet. Nuk dihet ku ndodhet. Ku e
mori vesh një djalë lagjeje, po e quaj, me para shumë që të ketë akses. Dhe këtu

shkatërrohet gjithçka.

Flavio Qarri: A është Rama kodoshi mes të dyve?

Tomorr Alizoti: Shiko. Rama është simboli. Është një shprehje e famshme që thotë, nuk janë fajtorë ata që bëjnë mëkatin por ai që krijon errësirën. Rama është errësirë. Pra në çdo vend të botës ka njerëz të tillë. Por shteti i largon, i ruan, i prangos. Ndërsa simboli që arrin të bëjë, drejtorin hajdut, ministrin hajdut, zëvendës kryeministren hajdute, gjithçka hajdutë, pirat është ky. Ky është errësira dhe dalin të gjithë në errësirë. Kjo është simbolika. Këdo që të kapin dhe të izolojnë nuk bie errësira. Errësira është ky. Rama është menaxheri, është truri që mbledh gjithë pisllekun dhe ky pisllek ka pushtuar kulmin e shoqërisë që është shteti. Pra shteti nuk ekziston më. Ai nuk ka ekzistuar prej kohësh dhe opozita e ka thënë këtë gjë. Por de facto sot shteti shqiptar është si ai mbreti lakuriq, nuk ka asnjë moral.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'4.9 milionë euro për një shkollë me 5 klasa më pak', Xhixho: Arsimi falas vetëm në letër



Mediu: Ka rënë piramida e sigurisë kombëtare! Rrezikohen marrëdhëniet me SHBA e vendet e NATO-s



'Mazhoranca i ka bërë bllok drejtësisë', Dedaj: Rama duhet të mbajë përgjegjësi politike

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Arrestimi i Vlora Hysenit/ REL: Opozita i kërkoi Begajt të merrte informacione para dekretimit të saj

'Në vend që të prekim realitetin, manipulojmë', eksperti: Qeveria la jashtë PISA-s shkollat rurale

TË NGJASHME



Në kulmin e krizës, Rama pritet të shtojë një taksë të re për naftën - 3 lekë për litër!



VIDEO/ 'O kriminel, o mafia' - Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA



'Burg, Burg' / Të rinjtë kapin 'mat' Bledi Çuçin në lokal, Delina Fico i godet nga tavolina, ish-ministri i nxjerr gishtin e mesit



'Nesër më shumë!'/ Mbyllet protesta e 117-të, qytetarët s'dorëzohen deri në dorëheqjen e Ramës



VIDEO/ Hoxha: Çfarë zbulon skandali i Vlora Hysenit për 'rrethin' e Ramës, 'po shkatërrohet shteti'



Nga shkarkimi në Kosovë te kreu i SHISH/ Berisha: Rama dhe Vlora Hyseni, nën urdhrat e Vuçiç! Haxhiu... kumbari



Skandali SHISH/ 'Jemi në alarm SOS', Abilekaj: Rama të japë dorëheqjen, të krijohet qeveri tranzitore...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.